

V E N D I M
Nr.483, datë 29.8.1994

**PËR VENDOSJEN E KUFIJVE MAKSIMALË TË ÇMIMIT TË SHITJES SË BARNAVE
NGA SUBJEKTET PRIVATE**

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë e të Mbrojtjes së Mjedisit dhe të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

1. Kufiri maksimal i çmimit të shitjes me shumicë të barnave nga subjektet private (depo ose qendra të tjera shpërndarëse) caktohet deri në 15 për qind mbi çmimin fillestar të blerjes CIF, konvertuar në lekë sipas kursit përkatës ditor që njoftohet nga Banka e Shqipërisë.

2. Kufiri maksimal i çmimit të shitjes me pakicë të barnave nga subjektet private (farmaci) caktohet deri në 35 për qind mbi çmimin e blerjes që del pas shtesës që i bëhet atij sipas pikës 1 të këtij vendimi, për barnat thelbësorë sipas listës së miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministria e Financave.

Çmimet e barnave të tjera jashtë kësaj liste liberalizohen.

3. Pika 3 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.17, datë 24.1.1994 "Për ndryshimin e çmimeve të shitjes me pakicë të barnave dhe vendosjen e kufijve maksimalë të shitjes së tyre nga subjektet private", shfuqizohet.

4. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministria e Financave nxjerrin udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 nëntor 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi